

VENDIM
Nr. 319, datë 6.5.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 419, DATË 14.4.2011, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E AFATEVE DHE TË SKEMËS SË
SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DËMSHPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT
POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4 e vendimit nr. 419, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama